



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 133 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së  
Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 3/691  
Datë: 5/12/2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pas shqyrtimit të kërkesës me Nr. Prot. 2/952, dt: 29.8.2017, të parashtruar nga prof. dr. Fehmi Krasniqi, profesor në FIM, për kompensimin e mjeteve për orët e mbajtura të lëndës Informatikës në FEFS, gjatë vitit akademik 2015/16. Në mbledhjen e mbajtur me datën 08.9.2017 merr, këtë:

### V E N D I M

- I. I REFUZOHET kërkesa me nr. Prot. 2/952, dt: 29.8.2017 për kompensimin e mjeteve në mënyrë retroaktive, për orët e mbajtura të lëndës Informatikës në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit gjatë semestrit verorë të vitit akademik 2015/16.
- II. Prof. Dr. Fehmi Krasniqi, mësimdhënës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, nuk posedon kontratë të vlefshme për angazhimin e tij me honorar për lëndën e Informatikës në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit gjatë semestrit verorë të vitit akademik 2015/16. Prandaj edhe nuk mund të kompensohet.
- III. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit, dhe është përfundimtar për organet e UP-së.

### A r s y e t i m

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoj kërkesës me Nr. Prot. 2/952, dt: 29.8.2017, të parashtruar nga prof. dr. Fehmi Krasniqi profesor i pensionuar në FIM për kompensimin e mjeteve në mënyrë retroaktive, pasi që i njëjti pretendon se me marrëveshje me ish dekanin e njësisë akademike të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit ka mbajtur orët e lëndës së Informatikës si i angazhuar gjatë semestrit verorë të vitit akademik 2015/16 në FEFS. Këshilli Drejtues konstatoi se baza ligjore për zbatimin e kërkesës së prof. dr. Fehmi Krasniqi për kompensim të mjeteve nuk ekziston, sepse i përmenduri në bazë të Rregullores për angazhime dhe akteve tjera me të cilat funksion Universiteti i Prishtinës nuk posedon kontratë valide për kompensimin e orëve sipas kërkesës së parashtruar, prandaj mbi këtë bazë KD-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës kompetente në afat prej 15 ditësh nga pranimi ( në kopje fizike apo elektronike) të këtij vendimi.

#### Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të Kërkesës;
3. Zyrës Ligjore të UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Prof. dr. Ismet Salihu - Kryesues